

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM KANÇELARIA GJENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL	
DATA PRANUAR / DORËZUAR 27.07.2015	
Shifra e klasifikimit	Nr. Regj.
-10-	471

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

**Raporti i Auditorit të pavarur dhe Pasqyrat Financiare
për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
1. Hyrje	5
2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit.....	5
2.1. Bazat e përgatitjes	5
2.2. Konventa e Kontabilitetit	5
2.3. Valuta raportuese	5
2.4. Prokurimi	5
2.5. Zotimet	6
2.6. Data e autorizimit.....	6
2.7. Buxhetet	6
2.8.Shpalosja e pasurive.....	6
Pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2014	7

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Auditorit të Përgjithshëm

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të Republikës së Kosovës (më tej referuar si “Organizata” ose “ZAP”), që përfshinë Pasqyrën e Pranimit të të Ardhurave dhe Pagesave, Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2014, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave financiare në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin Nr. 04/L-194 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr. 04/L-116, të cilët përcaktojnë që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme. Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; duke zgjedhur dhe zbatuar politika përkatëse të kontabilitetit; dhe duke bërë vlerësime kontabël që janë të arsyeshme në rrethanat përkatëse.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale. Auditimi përfshinë përmbushjen e procedurave për të fituar dëshmi të auditimit për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga vlerësimet e auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut të gabimeve materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne i kemi përdorur janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, Pasqyra e Pranimit të Parave dhe Pagesave dhe Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2014, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik – Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme.

Bazat e Kontabilitetit

Pa e modifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për Shënim 2.2 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan bazat e kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje bazën e kontabilitetit me para të gatshme.

Deloitte Korona B.p.a.

Prishtinë, Kosovë
3 korrik 2015

1. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është themeluar në vitin 2003 nën Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18, të datës 4 tetor 2002. Pas pavarësisë mandati dhe roli i Auditorit Gjeneral është specifikuar në Kushtetut¹. Rregullorja e UNMIK-ut u shfuqizua me Ligjin nr. 03/L-075 mbi Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të datës 05 qershor 2008.

Sipas Kushtetutës (Neni 138), Auditori i Përgjithshëm (AP) duhet që në baza vjetore të raportojë për rezultatet e auditimit (Raporti Vjetor i Auditimit dhe raportet për detyra të veçanta) dhe aktivitetet e tij personale (Raporti Vjetor i Performancës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit

2.1. Bazat e përgatitjes

Sipas ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë Nr. 03/L-048 dhe Ligjit Nr.04/L-194 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë paraprakisht të amendamentuar nga Ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr.04/L-116 Auditorit Gjeneral i kërkohet të përgatitë dhe dorëzojë Pasqyra Vjetore Financiare në përputhshmëri me kërkesat financiare dhe raportuese të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik ("SNKSP") në përputhje me bazën e kontabilitetit me para të gatshme. Për më shumë, këto pasqyra financiare përfshijnë shpalosjet të kërkuara nëpërmjet Rregullores Financiare Nr. 03/2013 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore.

Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk është shprehur ndryshe. Kërkesat shtesë janë zhvilluar gjatë viteve.

2.2. Konventa e Kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazën e kontabilitetit me para të gatshme. Sipas këtyre parimeve:

- a. Të hyrat njihen kur ato pranohen. Ato alokohen nga fondet në dispozicion në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK), sipas së cilës fondet e alokuara duhet të shpenzohen në kuadër të ndarjeve të tilla të njohura si "fondet e alokuara" për atë ndarje; dhe
- b. Shpenzimet njihen kur paguhen nga llogaria bankare e BKK.
- c. Pasuritë jo monetare janë prezantuar për qëllime të shpalosjeve. Kostoja historike e këtyre pasurive paraqet koston e blerjes dhe çdo shpenzim shtesë i lidhur drejtpërsëdrejti me blerjen e këtyre pasurive.

2.3. Valuta raportuese

Librat dhe shënimet e ZAP-it mbahen në Euro, valuta ligjore në territorin e Republikës së Kosovës.

2.4. Prokurimi

Marrëveshjet kontraktuese për blerje apo marrje me qira të mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë shërbimet profesionale, nënshkruhen, në emër të ZAP-it, vetëm nga zyrtarët e autorizuar. Aktivitetet për blerje apo marrje me qira, përveç nënshkrimit të kontratës, përfshijnë thirrjen për tenderë, kuotime apo propozime me furnitorë të mundshëm mbi bazën e specifikimeve të detajuara siç përcaktohet në Ligjin nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

¹ Neni 136, 137, 138 dhe 157

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit (vazhdim)

2.5. Zotimet

Zotimet, ashtu siç janë shpalosur në pasqyrat financiare, regjistrohen kur urdhërohet ndonjë blerje që ka të bëjë me vitin aktual buxhetor, edhe pse mallrat dhe shërbimet në të vërtetë janë pranuar/dhënë, dhe detyrimi është shkaktuar në buxhetin e vitit të ardhshëm.

2.6. Data e autorizimit

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014, janë autorizuar për lëshim nga ana e z. Artan Venhari, auditori i përgjithshëm dhe z.Fatmir Uka, zyrtar kryesor financiar me 31 janar 2015, dhe janë ri-dorëzuar pas një modifikim në 13 mars 2015.

2.7. Buxhetet

Buxheti final është i përfshirë në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar të Kosovës dhe gjithashtu është publikuar si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë së Kosovës.

2.8. Shpalosja e pasurive

Pasuritë mbahen për tu përdorur ose për qëllime administrative, dhe janë të paraqitura në notën e shpalosjes me vlerën e kostos minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga vjetërsimi, nëse ka. Kosto përmban çmimin e blerjes së pasurisë.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2014

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014

Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave të Parave të Gatshme

Shënimi	2014	2013	2013	2012
	Llogaria e Vetme e Thesarit BKK Euro 000'	Llogaria e Vetme e Thesarit BKK Euro 000'	Llogaria e Vetme e Thesarit e treta e treta Euro 000'	Llogaria e Vetme e Thesarit BKK Euro 000'
PRANIMET				
1 Granti Qeveritar	2,112	1,985	-	1,815
2 Grantet e përcaktuara të donatorëve	57	21	7*	7
Totali i Pranimeve	2,169	2,006	7	1,822
Pagesat				
3 Operacionet	1,480	1,268	-	1,174
4 Pagat dhe Mëditjet	644	614	7	561
5 Mallrat dhe Shërbimet	27	29	-	32
Totali i Pagesave	2,151	1,911	7	1,767
6 Transferet dhe Subvencionet	-	75	-	-
7 Shpenzimet Kapitale	18	20	-	55
Totali i Pagesave	2,169	2,006	7	1,822



Artan Venhari
Zëvendës Auditor i Përgjithshëm



Fatmir Ulka
Zyrtar Kryesor Financiar

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014

Pasqyra e Realizimit të Buxhetit

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale

	2014					2013	2012
	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Aktuali	Diferenca	Realizimi	Realizimi	
	A Euro 000'	B Euro 000'	C Euro 000'	D = C - B Euro 000'	E Euro 000'	F Euro 000'	
Shënime							
Hyrja e parashë së gatshme në llogari të Thesarit							
Donacionet	8	18	18	-	21	7	
Të hyra të tjera	9	4	4	-	-	7	
Pranimet totale të mbledhura për BKK-në							
Daljet e parashë së gatshme nga llogaritë e thesarit							
Pagat dhe mëditjet	10	1,480	1,480	-	1,268	1,174	
Mallrat dhe shërbimet	11	712	644	(22)	614	561	
Shërbimet publike	12	40	27	(7)	29	32	
Transferet dhe subvencio net		-	-	-	75	-	
Shpenzimet kapitale	13	30	18	(12)	20	55	
Totali i pagesave i bërë nga BKK nëpërmjet të LIVTh							
		2,210	2,169	(41)	2,006	1,822	

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Hyrje

Auditori i përgjithshëm është caktuar në vitin 2009 nga PCN-ja për një periudhë pesë vjeçare. Në qershor 2013, një marrëveshje është nënshkruar në mes të Ministrisë së Financave dhe Grupit Menaxhues Ndërkombëtar për mbështetje të vazhdueshme të emëruarve të Përfaqësuesve Civil Ndërkombëtar, të cilat emërimet janë vazhduar pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur. Pas kësaj marrëveshjeje, një Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar mes Ministrisë së Financave dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për transferimin e mjeteve prej buxhetit të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës tek Grupi Menaxhues Ndërkombëtar për mbështetje të vazhdueshme të të emëruarve.

Auditori i Përgjithshëm është përgjegjës për udhëheqjen e përgjithshme të Zyrës së Auditorit të përgjithshëm dhe të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të Zyrës. Strategjia e zhvillimit korporativ e ZAP-it definon misionin e ZAP-it dhe jep një vizion të qartë për periudhën.

Objektivi i misionit strategjik të ZAP-it është bazuar në auditimin e duhur të cilësisë së sektorit publik, duke kontribuar në ndërtimin e një menaxhimi të shëndoshë financiar në administratën publike të karakterizuar nga përgjegjësitë e forta menaxheriale për përdorimin transparent të burimeve publike dhe rezultatet e arritura nga politikat. Auditori i Përgjithshëm synon të ndërtojë Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, plotësisht funksionale dhe e gatshme të marrë vendin e saj në mesin e Institucioneve të Larta të Auditimit të Evropës. Një organizatë e tillë do të udhëhiqet plotësisht nga shtetasit e Kosovës dhe do të jetë plotësisht e qëndrueshme. Acquis Communautaire dhe PVPE 2008 sigurojnë themele të forta mbi të cilat janë të bazuara ky mision dhe vizion. Baza ligjore është e mbështetur në Kushtetutë, Ligji mbi ZAP-in si dhe kornizën e përgjithshme ligjore lidhur me menaxhimin dhe administrimin e financave publike.

Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2014 janë përgatitur në përputhje me SNKSP- Parimet e bazuara në parinë e gatshme si dhe Rregullës Financiare Nr.03/2013 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore.

Shënim 1

Ndarja e fondit të përgjithshëm

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2014	2013	2012
		BKK	BKK	BKK
		Euro '000	Euro '000	Euro '000
Pagat dhe mëditjet		1,480	1,268	1,174
Mallrat dhe Shërbimet		587	593	554
Shërbimet Publike		27	29	32
Subvencionet dhe transferet		-	75	-
Shpenzimet kapitale		18	20	55
Totali		2,112	1,985	1,815

Shpenzimet e realizuara sipas Shënitimit I lidhen me fondet e marra nga Fondi i Përgjithshëm.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shënim 2

Grantet e përcaktuara të donatorëve

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2014	2013	2012
		BKK Euro 000'	BKK Euro 000'	BKK Euro 000'
Mallrat dhe Shërbimet		57	21	7
Total	2.1	57	21	7

2.1. Këto shpenzime përfshijnë:

- 7,000€ - donacion i dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, për të bashkë-financuar konferencën e VI-të vjetore;
- 10,000€ - donacion i dhënë nga Bashkimi Evropian/Projekti i Binjakëzimit për të bashkë-financuar konferencën e VI-të vjetore;
- 837.7€ - donacion i dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë për marrje me qira për dy ditë të hapësirave punuese; dhe
- Shpenzimi në vlerë prej 39,029€ i regjistruar në kontabilitetin e Thesarit si donacion nga Banka Botërore për financimin e projektit i cili është i fokusuar në zhvillimin e aftësive profesionale të auditimit të sistemeve të prokurimit nuk është rimbursuar gjatë vitit 2014.

Shënim 3

Pagat dhe mëditjet

Përshkrimi	Shënime	2014	2013	2012
		BKK Euro 000'	BKK Euro 000'	BKK Euro 000'
Neto pagat		1,240	1,066	988
Tatimi mbi të ardhurat personale		96	77	71
Kontributi pensional i punëdhënësit		70	60	56
Kontributi pensional i punëtorit		70	60	56
Pagesat për sindikata -0.10% deri 0.50%		4	5	3
Totali		1,480	1,268	1,174

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shënim 4

Mallra dhe shërbime		2014	2013	2012
		BKK	BKK	BKK
Përshkrimi		Euro 000'	Euro 000'	Euro 000'
Pagesat nga BK	Shënime			
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	4.1	35	33	30
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	4.2	35	31	21
Internet	4.3	1	3	3
Shpenzimet tjera telefonike		22	23	20
Shpenzimet postare		1	1	1
Shërbimet e anëtarësimit dhe trajnimit	4.4	98	108	36
Shërb e ndr. intelektuale këshillëdhënëse	4.5	66	57	77
Shërbimet kontraktuale tjera		22	23	8
Shërbime teknike		1	1	2
Shpenzimet për anëtarësim		2	1	1
Mobiljet dhe pajisjet (nën 1000€)	4.6	9	2	10
Telefona (nën 1000€)		-	0	3
Kompjuterë (nën 1000€)	4.7	34	0	26
Harduer për TI (nën 1000€)		-	0	5
Pajisje tjera (nën 1000€)		2	2	15
Furnizime për zyrë	4.8	5	25	12
Furnizime ushqim dhe pije	4.9	20	12	17
Furnizime pastrimi		-	2	3
Furnizime veshmbathje		-	1	-
Akomodimi	4.10	23	5	5
Vaj për ngrohje	4.11	8	12	6
Derivate për gjenerator		1	-	1
Karburant për vetura		8	11	8
Regjistrimi i automjeteve		1	1	-
Sigurimi i automjeteve	4.12	2	5	5
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		14	13	12
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	4.13	9	13	6
Mirëmbajtja e ndërtesave		14	13	15
Mirëmbajtja e tekn.informative	4.14	10	14	12
Mirëmb.e mobileve dhe pajisjeve		1	1	2
Qiraja për ndërtesa		168	168	168
Qiraja-përdorime tjera	4.15	24	19	16
Reklamat dhe konkurset		1	1	3
Shërbime shtypje -jo marketing	4.16	5	9	10
Informimi publik		-	-	1
Drekat zyrtare	4.17	1	3	1
Qiraja-përdorim i hapësirave		1	1	-
Totali		644	614	561

4.1 Këto shpenzime reflektojnë punën e ekipeve të auditimit në terren - akomodimi në hotele gjatë auditimit të Komunave të cilat janë më shumë se 50 km larg Prishtinës. Diferenca në mes të shpenzimeve të vitit 2014 dhe 2013 ka të bëjë me rritjen e numrit të komunave të audituara nga stafi ynë e që ndikon në shtimin e numrit të ekipeve të auditimit për këto komuna.

4.2 Zgjerimi i bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar është pjesë e portfolios tonë dhe kjo reflekton në ngritje të shpenzimeve në vitin 2014. Mjetet e shpenzuara ndërlidhen me pjesëmarrje të stafit në punëtori; konferenca jashtë Kosovës dhe shpenzimet e përdorura për auditim të ambasadave (Punëtorja në Shqipëri, Suedi, Sarajevë, Kongresi i EUROSAT-t, Rrjeti i ISA-ve për vendet potenciale të BE-së, auditimi i ambasadave në Bruksel, France, Suedi, dhe Gjermani dhe zyrën e konsullatës në Frankfurt).

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shënim 4

Mallra dhe shërbime (vazhdim)

4.3 Shpenzimet më të ulëta në 2014 krahasuar me vitin 2013 janë për shkak se operatori i ri i kontraktuar në dhjetor të 2013 për furnizim me internet ka ofruar çmim shumë më të volitshëm/ulët se operatori paraprakë.

4.4 Kjo shumë paraqet shpenzimet për pagesën e trajnimeve të mbajtura për auditorë nga SHKÇAK. Shpenzimet më të ulëta krahasuar me vitin 2013 janë për shkak se një numër i caktuar i moduleve të skemës së re të certifikimit për sektorin publik janë finalizuar gjatë vitit 2013. Në këtë shpenzim përfshihet edhe shumë prej 2,413€, e cila është paguar UBT për organizimin e provimit me qëllim të certifikimit të stafit tonë menaxhues në programin "Sistemet e menaxhimit të Cilësisë", - standardi ISO 9001.

4.5 Kjo shumë paraqet pagesat e bëra kompanisë private të auditimit KPMG për auditimin e PVF-ve të vitit 2013 të komunave të Kosovës dhe kompanisë private të auditimit Deloitte Kosova për auditimin e ndërmjetëm për këto Komuna për vitin 2014. Përveç kësaj, në këtë shpenzim është përfshirë edhe pagesa në vlerë prej 28,700€ nga donacioni i Bankës Botërore për ekspertet e angazhuar në projektin për zhvillimin e aftësive profesionale të stafit në auditimin e sistemeve të prokurimit në sektorin publik.

4.6 Këtë vit është bërë furnizimi me 120 karrige me jastëk shkrimi për nevoja të sallën së trajnimeve, duke bërë kështu një përdorim më të mirë të hapësirës.

4.7. Kjo shumë prezanton shpenzimet për furnizim me Laptop.

4.8. Shpenzimet më të ulëta në 2014 krahasuar me vitin 2013 kanë të bëjnë me faktin se këtë vit nuk është blerë material për zyrë. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ka pasur operatorë ekonomik të përgjegjshëm në tre proceset e prokurimit.

4.9 Në këtë shumë përfshihen: shpenzimet që ndërlidhen me konferencën e gjashtë vjetor të mbajtur në Tiranë nga 09 - 11, Korrik, (7,679€ është shumë e paguar nga ZKAS dhe Projekti i Binjakëzimit i BE-së); shpenzimet për furnizim me ujë për pije, shpenzimet për organizimin e ndejës së fundit si dhe shpenzimet e mikpritjes për ngjarje të ndryshme (shihni Shënimin Shpjegues 21 pikat a dhe b).

Shpenzimet më të larta në 2014 krahasuar me 2013 paraqiten për shkak se më parë shumë prej 7,000€, si bashkëfinancim i konferencës vjetore nga projekti i binjakëzimit në vitin 2013, është prezantuar në kolonën - Pagesat nga palët e treta. Këtë mjetet e bashkëfinancimit janë transferuar si donacion në kategorinë Mallra dhe Shërbime.

4.10. Kjo shumë prezanton shpenzimin për akomodim të stafit tonë si dhe delegacioneve pjesëmarrëse në konferencën e gjashtë vjetore. Në këtë shpenzim është përfshirë edhe: a) pagesa prej 10,329€ nga donacioni i Bankës Botërore për akomodim të ekspertëve të kontraktuar nga BB gjatë misionëve të tyre në ZAP; dhe b) pagesa prej 10,000€ nga donacioni i ZKAS dhe Bashkimit Evropian për bashkëfinancim të konferencës së mbajtur në Tiranë.

4.11. Në vitin 2014 është përdorur një sasi e pashfrytëzuar e vajit për ngrohje nga vitit 2013, si shkak i kushteve të mira klimatike.

4.12 Shpenzimet më të ulëta gjatë vitit 2014 janë për shkak që në kontratën e re të nënshkruar në dhjetor të 2013 për sigurim të automjeteve zyrtare ka një zbritje mjaft të theksuar në pozicionin e Sigurimit KASKO për të gjitha llojet e automjeteve (afërsisht 77%).

4.13. Kjo shumë paraqet shpenzimet për mirëmbajtje dhe servisim të veturave zyrtare. Dallimi me periudhën e njëjtë të vitit 2013 ndërlidhet me faktin që gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur nevoja për furnizim me goma të reja si dhe janë evidentuar më pak prishje të veturave zyrtare

4.14. Shpenzimet më të ulëta krahasuar me vitin 2013 janë si shkak i mos paraqitjes së nevojave për furnizim

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

me bateri për laptop si dhe servisim të pajisjeve të Teknologjisë Informative.

Shënim 4

Mallra dhe shërbime (vazhdim)

4.15 Kjo shumë paraqet shpenzimet për marrjen me qira të softuerit për regjistrim të kohës, marrjen me qira të pajisjeve për zërim gjatë konferencës së VI-të në Tiranë si dhe marrjen me qira të fotokopjeve për nevoja të kryerjes së punëve. Pasi që specifikat teknike për fotokopjet e kontraktura në fund të 2013 janë më avancuara se ato paraprake, kjo ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve në këtë kod ekonomik në vitin 2014.

4.16. Shpenzimet më të ulëta krahasuar me vitin 2013 janë për shkak të çmimeve më të ulëta të ofruara nga operatori i kontraktuar në vitin 2014 për shtypje dhe lidhje të RVP & RVA.

4.17 Këto shpenzime ndërlidhen me vizitat e delegacioneve të bërë institucionit tonë.

Shënim 5

Shërbime komunale

Përshkrimi	Shënime	2014	2013	2012
		BKK	BKK	BKK
		Euro 000'	Euro 000'	Euro 000'
Rryma		19	18	19
Uji		1	2	1
Mbeturinat		1	1	1
PTK - Fikse	5.1	6	8	11
Totali		27	29	32

5.1 Implementimi i pakos biznese të aranzhuar me kontratë ka rezultuar me zvogëlim të nevojave për shfrytëzim të telefonisë fikse.

Shënim 6

Subvencione dhe transfere

Përshkrimi	Shënime	2014	2013	2012
		BKK	BKK	BKK
		Euro 000'	Euro 000'	Euro 000'
Kontributet për paga		-	75	-
Totali		-	75	-

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shënim 7

Shpenzime kapitale

Përshkrimi	Shënime	2014	2013	2012
		BKK Euro 000'	BKK Euro 000'	BKK Euro 000'
Blerje e licencave për softuerin IDEA		-	-	-
Blerje e serverëve		-	-	55
Softuer për intranet		3	6	-
Pajisje tjera (skaner dhe fajlla metalik)		-	10	-
Softuer për dizajnim të raporteve (Adobe Suite)		-	4	-
Softuer për menaxhim të burimeve njerëzore		8	-	-
Softuer për regjistrimin e kohës		7	-	-
Totali		18	20	55

Shënim 8

Donacionet

Emri i Donatorit	Shënime	Nr. i projektit	Emri i projektit	2014
				Euro 000'
Donacioni nga Banka Botërore	8.1	94134	Zhvillimi i aftësive për auditim të sistemeve prokuruese në Kosovë	43
Donacioni nga Qeverisa Suedeze		96207	Bashkëfinancim për konferencën e VI-të vjetore	7
Donacioni nga Qeverisa Suedeze		96208	Qira për hapësirë punuese	1
Bashkimi Binjakëzimit	Europian/Projekti i	94916	Bashkëfinancim për konferencën e VI-të vjetore	10
Total				61

8.1 Mjetet në vlerë prej €43,334 janë transferuar nga Buxheti i Kosovës në fondin burimor të Bankës Botërore. Nga këto 39,029€ janë shpenzuar dhe të njëjtat ende nuk janë rimbursuar nga donacioni i Bankës Botërore

Shënim 9

Të hyra të tjera

Shumat e mëposhtme paraqesin të hyrat e gjeneruara nga auditimet tona të fondeve të donatorëve.

a) 2,720€ - nga auditimi i Pasqyrave financiare të programit DANIDA për vitin e përfunduar me 31.12.2013(marrëveshja MASHT/Danida);

b)1,005€ - nga auditimi i Pasqyrave financiare të TAMAD-it, për periudhën Shtator 2012 - Dhjetor 2013

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

(marrëveshja me TAMAD);

Shënim 9

Të hyra të tjera (vazhdim)

c) 860€ - nga auditimi i projektit: Rindërtimi i rrugës "Brigadat Kosovare" - Pejë (marrëveshja me UN Habitat No. 09/2013);

d) 635€ - nga auditimi i projektit: Zhvillimi i parkut natyror "MORONICA" - Junik (marrëveshja me UN Habitat Nr. 09/2013).

Shumat nën pikat a dhe b janë pranuar dhe regjistruar në Thesar si të hyra tona të realizuara nga shitja e shërbimeve profesionale. Shumat nën pikat c dhe d janë po ashtu të hyra tona por janë regjistruar në Llogarinë kryesore të Buxhetit të Kosovës. Asnjëra nga këto shuma nuk janë përdorur nga ne.

Shënim 10

Pagat dhe mëditjet

Me Ligjin e Buxhetit për vitin 2014, në kategorinë Paga dhe Mëditje shuma e aprovuar ishte në vlerë 1,349,253€. Nga prilli i vitit 2014 ka filluar të implementohet vendimi i Qeverisë së Kosovës për ngritje të pagave për të gjithë shërbyesit civil në nivelin 25%. Si rezultat i kësaj buxheti final i alokuar në këtë kategori ekonomike në fund të vitit 2014 është 1,480,232€.

Diferenca prej 130,979€ është kompensuar nga reduktimi i alokimeve në kategoritë Mallra dhe Shërbime dhe Shërbime komunale (shih shënimin shpjegues 10 dhe 11) ndërsa shuma prej 18,254€ është alokuar nga Ministria e Financave - kontigjenca për paga.

Shënim 11

Mallra dhe shërbime

Me Ligjin e buxhetit për vitin 2014 shuma e aprovuar për Mallra dhe Shërbime ishte 711,500€. Bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 07/172, datë 27.02.2014, për kursimin e shpenzimeve nga Organizatat Buxhetore në nivelin 15% të shumës së alokuar nga ndarja buxhetore në kategoritë Mallra dhe Shërbime, në tremujorin e katërt i është reduktuar alokimi i mjeteve në këtë kategori në shumën prej 106,725€. Shuma e njëjtë është bartur në Paga dhe Mëditje. Gjatë vitit 2014, në këtë kategori ekonomike janë transferuar donacionet në shumën 61,172€ (shih shënimin 7).

Shënim 12

Shërbimet komunale

Me Ligjin e buxhetit për vitin 2014 shuma e aprovuar për Shërbime Komunale ishte 40,000€. Bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 07/172, datë 27.02.2014, për kursimin e shpenzimeve nga Organizatat Buxhetore në nivelin 15% të shumës së alokuar nga ndarja buxhetore në kategoritë Shërbime komunale, në tremujorin e katërt është reduktuar alokimi i mjeteve në këtë kategori në shumën prej 6,000€. Shuma e njëjtë është bartur në Paga dhe Mëditje.

Shënim 13

Shpenzimet kapitale

Me Ligjin e buxhetit për vitin 2014 ne kemi pasur të aprovuara dy projekte kapitale, Softuerin për regjistrim të kohës dhe Softueri për menaxhimin e BNJ. Sistemi për regjistrimin e kohës është finalizuar plotësisht. Softueri për menaxhimin e BNJ është finalizuar pjesërisht. Rekrutimin elektronik (lot 2 i SMBNj) nuk mundëm ta prokurorim për shkak se nuk ka pasur mjaftueshëm operatorë ekonomik të përgjegjshëm (shih Shënimin Shpjegues 6).

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shpalosja e detyrimeve (Neni 15)

Pasqyra e obligimeve të organizatës buxhetore

**Përmbledhj
a**

2014

Data e faturës	Numri i faturës	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	Arsyeja e mos pagesës	Shuma
3.12.2014	14-210-001-962	30 ditë	Zëri	Konkurs	Skadimi i afatit për zotim	120.00
14.01.2015	2596/14	30 ditë	Petroll company	Naftë për vetura	Këto fatura të pranuar në muajin Janar të këtij viti, pasqyrojnë obligimet për shërbimet e dhëna nga furnitorët relevantë gjatë muajit Dhjetor - 2014.	88.29
9.01.2015	123114414-15	30 ditë	Dardafon	Telefonia mobile		1,994.76
8.01.2015	dpr16303	30 ditë	KEDS	Rryma		2,087.49
9.01.2015	Dec-15	30 ditë	KIOSK	Gazetat ditore		67.60
9.01.2015	D890	30 ditë	DELTA SECURITY	Sigurimi fizik		526.71
6.01.2015	K00020	30 ditë	MSS	Mirëmbajtja e objektit		1,168.00
5.01.2015	I	30 ditë	ART HOUSE	Qiraja për fotokopje		1,514.63
Totali:						7,567.48

Detyrimet kontingjente

Natyra e detyrimeve kontingjente	Shënim	2014	2013	2012
		KCB	KCB	KCB
		Euro 000'	Euro 000'	Euro 000'
Qiraja	15.1	10	10	10
Totali		10	10	10

15.1 Shuma e prezantuar është një llogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-zyrës sonë që mund të kërkohen nga pronari në bazë të padisë.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shpalosja e pasurive (Neni 16)**16. a) Përmbledhje e pasurive jofinanciare (me vlerë mbi 1,000 Euro) në pronësi të organizatës buxhetore**

Përshkrimi	Shënime	2014	2013	2012
		BKK Euro 000'	BKK Euro 000'	BKK Euro 000'
Veturat	16a.1	-	-	23
Pajisje të TI-së	16a.2	35	63	83
Pajisje të tjera		7	11	9
Pasuritë e paprekshme	16a.3	27	10	-
Total		69	84	115

16a.1. Të gjitha veturat zyrtare (gjashtë vetura dhe një kombi) kanë arritur vlerën neto zero në fund të vitit 2013. Megjithatë, të gjitha këto janë duke u përdorur nga zyra jonë.

16a.2 Diferenca mes vitit 2014 dhe 2013 ka të bëjë kryesisht me zhvlerësimin e serverëve. Pajisjet e TI-së kanë normë të lartë të zhvlerësimit.

16a.3 Blerjet e reja në vitin 2014, në këtë kod arrijnë vlerën 15,196€ (shih shënimin shpjegues 6). Zhvillimi i softuerit të intranetit filloi në vitin 2013 dhe përfundoi në fillim të vitit 2014. Kësti i parë dhe i dytë janë paguar në vitin 2013 dhe të njëjtat janë regjistruar në SIMFK si "Investim në vijim" ndërsa kësti i fundit në vlerë prej 2.595€ është paguar në vitin 2014 dhe pastaj është regjistruar në SIMFK si "Pasuri e paprekshme" me vlerën e plotë prej 8,649€.

16. b) Përmbledhje e pasurive jofinanciare (me vlerë nën 1,000 Euro) në pronësi të organizatës buxhetore

Përshkrimi	Shënim	2014	2013	2012
		Vlera neto Euro 000'	Vlera neto Euro 000'	Vlera historike Euro 000'
Mobilje dhe pajisje		97	101	115
Totali	16b.1	97	101	115

16b.1 Blerjet e reja në vitin 2014, në këtë kod arrijnë vlerën 47,580€ për 60 laptop. Vlera prej 38,743€ paraqet vlerën e zhvlerësimit

**16.c). Përmbledhje e stoqeve në fund të periudhës
Klasifikimi i pasurive**

Klasifikimi i pasurive Përshkrimi	Shënime	2014	2013	2012
		Euro 000'	Euro 000'	Euro 000'
Material shpenzues		12	15	13
Derivate për ngrohjen qendrore		4	5	5
Totali		16	20	18

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shtojca 1

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Shpërndarjet e Autorizuara nga LMFPP

Kategoria e ndarjes	Shënim	Ndarja fillestare buxhetore		Ndryshimi sipas nenit 30, Ligji nr.03/L-048		Ndryshimi sipas nenit 29, Ligji nr.03/L-048, Buxheti final		Ndryshimet për grantet e përcaktuara te donatorëve		Ndarjet finale te buxhetit SIMFK	Ndryshi me e buxhetit fillestar
		Euro 000'	a	Euro 000'	b	Euro 000'	c	Euro 000'	Euro 000'		
Hyrjet											
Granti qeveritar											
Grantet e përcaktuara të donatorëve	18.1								18	18	
Të hyra të tjera	18.2							4	4	4	
								4	18	22	
Daljet (buxheti)											
Pagat dhe mëdritjet	18.3	1,349		1,349		1,480		-		1,480	8.8%
Mallrat dhe shërbimet	18.4	712		712		605		-	61	666	(6.8%)
Shërbimet komunale	18.5	40		40		34		-		34	(17.6%)
Transferet dhe subvencionet		-		-		-		-		-	
Shpenzimet kapitale		30		30		30		-		30	
Fondi i privatizimit		-		-		-		-		-	
Totali		2,131		2,131		2,149		-	61	2,210	3.7%

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014

Shënime:

- 18.1. Shih shënimin shpjegues nr. 8
- 18.2. Shih shënimin shpjegues nr. 9
- 18.3. Shih shënimin shpjegues nr. 10
- 18.4. Shih shënimin shpjegues nr. 11
- 18.5. Shih shënimin shpjegues nr. 12

Shtojca 2 (Neni 19)
Numri i punëtorëve

Departamenti	Nr i punëtorëve ne Ligjin e buxhetit 04/L-079	Nr. aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2013	Nr. aktual i punëtorëve në fund të vitit 2013
Stafi (Auditorë & Mbështetës)	146*	148**	147***

Shënim:

* Numri aktual i kufirit të punëtorëve është 146 duke përfshi Auditorin e Përgjithshëm dhe U.D. Drejtori i Përgjithshëm që janë jashtë sistemit të listë-pagesave (payrollit). Auditori i Përgjithshëm pritet të emërohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2015. Që nga fillimi i shtatorit, Ushtruesi i Detyrës Drejtor i Përgjithshëm është duke u paguar nga kategoria Mallra dhe Shërbime deri në miratimin e ligjit të ri.

** Numri aktual i punëtorëve në fillim të vitit ishte 148, për shkak të faktit se katër (4) zëvendësues u pranuan për zëvendësimin e stafit në pushim të lehonisë. Në këtë numër të punëtorëve nuk është i përfshirë Auditori i Përgjithshëm dhe U.D. Drejtori i Përgjithshëm

*** Në fund të vitit 2014, numri i përgjithshëm i punëtorëve të përfshirë në listat e pagave është 147 duke përfshirë edhe katër zëvendësuesit e stafit në pushim të lehonisë. Diferenca mes numrit të punëtorëve në fillim të vitit dhe atij në fund të vitit është për shkak të ndërprerjes së kontratës së njërit anëtar të stafit.